



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 27 Prot.

Vlorë më, 14.05. 2018

V E N D I M

Nr. 6 14/05/2018

Bazuar në nenin 47 dhe germën "dh" të pikës 1 të nenit 49 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në nenit 30, neni 52 pika 2, neni 53 pika "a", të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit;

Bordi i Administrimit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" (në vijim KUPV);

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret që duhet të plotësojë kandidati për Administrator të KUPV ,si më poshtë;
 - Të jetë shtetas shqiptar,
 - Të ketë arsim të lartë ,së paku në nivelin 'Master i Shkencave' në fushën e Drejtësisë apo të ekonomisë;
 - Të ketë përvojë punë 7(shtatë) vjecare në këto fusha;
 - Të mos ushtrojë funksion tjetër akademik apo administrativ;
 - Të ketë përvojë pune në buxhetimin dhe menaxhimin e fondeve, së paku 3 (tre) vjet;
 - Të mos jetë i dënuar për ndjekje penale dhe të mos jetë dhënë ndaj tij masë e sigurimit personal;
 - Të mos jetë i dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore, që nuk është shuar sipas ligjit;
 - Të ketë vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës;

2. Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:
 - Kërkesë me shkrim për aplikim;
 - Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
 - Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
 - Kopje e noteruar e diplomës/diplomave dhe/ose njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit), bashkë me listë notash të noteruara (të dy cikleve të studimit);
 - Kopje e librezës së punës e noteruar;
 - Vërtetim i gjendjes shëndetësore (raport mjekësor për aftësinë në punë);
 - Dëshmia e penaltetit ose mandat-pagesa e saj, si dhe formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, sipas formës së kërkuar nga ligji;
 - Vërtetim nga punëdhënës të mëparshëm, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
 - Dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
 - Referenca nga punëdhënës të mëparshëm, që provojnë vlerësimet pozitive në punë;
3. Këto kritere të përdoren për të shpallur konkursin për pozicion pune, bazuar në ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe Vendimin e Bordit të Administrimit të KUPV për vendin e punës "Administrator" në Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë".
4. Ngarkohet Zyra e Burimeve Njerëzore, Protokollit dhe Arkivës me organizmin e shpalljes publike, depozitimin e dokumentacionit, përcjelljen e tyre sekretarisë teknike të Bordit të Administrimit.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

PhD Siri Hoxha

